

A L B A N I A N

B A S I C C O U R S E

V o l u m e V

L e s s o n s 47-54

J a n u a r y 1966

R e v i s e d O c t o b e r 1980

D E F E N S E L A N G U A G E I N S T I T U T E  
F O R E I G N L A N G U A G E C E N T E R

## PREFACE

The Albanian Course, consisting of 120 lessons in 10 volumes, is one of the Defense Language Institute's Basic Course Series.

The course is designed to train native English language speakers to Level 3 proficiency in comprehending, speaking, reading and writing Albanian. The texts are intended for classroom use in the Defense Language Institute's intensive programs. Tapes accompany the texts.

This volume was revised in October 1980 to update factual information. Morphological, syntactical, and vocabulary changes were also made.

## Table of Contents

	<u>Page</u>
<b>LESSON 47</b>	
Grammar Perception Drill	2
Dialogue Number 47	4
Main Features:	
The admirative mood. Conjugation of <u>me ngá</u> , <u>me pré</u> , <u>me thye</u> ( <u>me krye</u> ), <u>me vdeke</u>	
Adjectives used as nouns	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 47	6
Grammar Analysis:	7
Adjectives used as nouns (masculine)	
Grammar Drill	10
Translation Exercises	17
Reading Text and Questions	20
Homework	23
Vocabulary	24
 <b>LESSON 48</b>	
Grammar Perception Drill	27
Dialogue Number 48	33
Main Features:	
Nouns denoting family relationship (masculine). Conjugation of <u>me trokitë</u> , <u>me përkitë</u> , <u>me thirrë</u> (key: <u>me bërtitë</u> ), <u>me zâne</u> , <u>me përshëndetë</u> (key: <u>me matë</u> )	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 48	36
Grammar Analysis:	
Nouns denoting family relationship	
Grammar Drill	38
Reading Text and Questions	40
Homework	48
Vocabulary	51
	52
 <b>LESSON 49</b>	
Grammar Perception Drill	54
Dialogue Number 49	57
Main Features:	
Adjectives used as nouns (feminine). Conjugation of <u>me u-mjoftë</u> <u>me</u> ..., <u>me dashë</u> (simple past).	

	<u>Page</u>
Use of the verb <u>me pasë</u> substituting the possessive <u>adjectives</u> .	
<u>me leje</u> versus <u>më falni</u>	59
Idiomatic Translation of Dialogue No. 49	60
Grammar Analysis:	
Adjectives used as nouns (feminine)	
<u>me leje</u> - <u>më falni</u>	
Omission of the possessive adjective	63
Grammar Drill	72
Translation Exercises	74
Reading Text and Questions	76
Homework	77
Vocabulary	
<b>LESSON 50</b>	
Grammar Perception Drill	79
Dialogue Number 50	86
Main Features:	
Nouns denoting family relationship (feminine). The present participle (replacing the future). The conditional	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 50	89
Grammar Analysis:	91
Nouns denoting family relationship (feminine). The conditional	
Grammar Drill	94
Reading Text and Questions	100
Homework	103
Vocabulary	104
<b>LESSON 51</b>	
Grammar Perception Drill	108
Dialogue Number 51	113
Main Features:	
The use of the subjunctive. The use of the present as a future tense. The imperative with an object.	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 51	116

	<u>Page</u>
	118
Grammar Analysis:	
The subjunctive	121
The imperative with an object	128
Grammar Drill	131
Reading Text and Questions	132
Homework	
Vocabulary	
 LESSON 52	
Grammar Perception Drill	135
Dialogue Number 52	142
Main Features:	
The pluperfect. The conditional perfect tense. The pluperfect subjunctive (active and passive verbs)	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 52	145
Grammar Analysis:	147
The pluperfect. The pluperfect subjunctive. The conditional perfect tense.	
Grammar Drill	150
Reading Text and Questions	156
Homework	159
Vocabulary	160
 LESSON 53	
Grammar Perception Drill	163
Dialogue Number 53	169
Main Features:	
Prepositions governing all five cases.	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 53	172
Grammar Analysis:	174
Prepositions	
Grammar Drill	177
Reading Text and Questions	185
Homework	188
Vocabulary	189

Page

LESSON 54

Grammar Perception Drill	191
Dialogue Number 54	196
Main Features:	
Idioms with the dative replacing the possessive adjective.	
Idioms with the dative replacing the accusative with preposition <u>për</u> .	
Agent nouns derived from past participle.	
Idiomatic Translation of Dialogue No. 54	199
Grammar Analysis:	201
Idioms with the dative	
Agent nouns	
Grammar Drill	204
Reading Text and Questions	210
Homework	214
Vocabulary	215



## PJESA E PARË

## USHTRIME GRAMATIKORE PARAPRAKE-GRAMMAR PERCEPTION DRILL

1. Unë kam në xhep 100 dollarë.  
 Ti qenke i pasun!  
 Ju këni të hoila shumë në bankë.  
 (me qenë i pasun): Ju qenkeni i pasun!  
 Ai s'ka asnjë lek në emën të tij.  
 (me qenë i vorfën): Ai qenka i vorfën!  
 Na vijmë në shkollë në orën 7.  
 (me ardhë heret): Na ardhkemi heret!  
 Ata hanë 5 herë në ditë.  
 (me hangër shumë): Ata hangërkan shumë!  
 Unë flëj 10 orë në natë.  
 (me fjetë shumë): Ju fjetkeni shumë!  
 Ai shkon në Durrës çdo fund jave.  
 (me shkue shpesh): Ai shkueka shpesh në Durrës!  
 Na studjojmë katër orë në mbrëmje.  
 (me studjue shumë): Ju studjuekeni shumë në mbrëmje.  
 Ata s'kanë as bukë me hangër.  
 (me qenë shumë të vorfën): Ata qenkan të vorfën!  
 Ndër disa krahina të Shqipërisë bje 200 cm. shi në vjet.  
 (me rá shi shumë): Ndër disa krahina të Shqipërisë raka shi shumë!  
 Unë pij tri gota qumësht në mëngjes.  
 (me pi shumë qumësht): Ju pikeni shumë qumësht!  
 Unë bëj 15 minuta me ardhë në kambë nga shtëpia në Presidio.  
 (me ecë shpejt): Ju eckeni shpejt!  
 Ju shkrueni shqip pa gabime.  
 (me shkruë mirë): Ju shkruëkeni mirë shqip!
2. A është dhetë vjeç djali i madh i Zotni Elbasanit?  
 Po, djali i madh i Zotni Elbasanit është dhetë vjeç.  
 A është i madhi dhetë vjeç?  
 Po, i madhi është dhetë vjeç.  
 Sa vjeç është i madhi?  
 I madhi është dhetë vjeç.  
 Cili djalë është dhetë vjeç?  
 I madhi është dhetë vjeç.  
 A është tetë vjeç djali i vogël i Zotni Elbasanit?  
 Po, djali i vogël i Zotni Elbasanit është tetë vjeç.



A është i vogli tetë vjeç?  
 Po, i vogli është tetë vjeç.  
 Sa vjeç është i vogli?  
 I vogli është tetë vjeç.  
 Cili djalë është tetë vjeç?  
 I vogli është tetë vjeç.

A është i madhi në klasën e katërt?  
 Po, i madhi është në klasën e katërt.  
 A janë librat e të madhit në çantë?  
 Po, librat e të madhit janë në çantë.  
 A i tha mësuesi të madhit me studjue më shumë?  
 Po, mësuesi i tha të madhit me studjue më shumë.  
 A e patë ju të madhin tue shkue në shkollë vetëm?  
 Po, na e pamë të madhin tue shkue në shkollë  
 vetëm.  
 A mori i vogli dy lapsa prej të madhit?  
 Po, i vogli mori dy lapsa prej të madhit.

---

### Kuriozitet i arsyeshëm


Nji djalë pesëvjeçar e pyeti t'amën:

- Nanë, sa kushton nji kilogram foshnje?
- Ç'pyet kështu, im bir? Foshnjat nuk shiten.
- E pse pra i peshojnë porsa të lejnë?

Nji aksident me automobil

1. Pse je i mërzitun?
2. Si mos me qenë! Nji prej djelmvet të mij ka pasë nji aksident me automobil.
3. Cili? Djali i vogël?
4. Jo, i madhi; i vogli është shumë i kujdesshëm.
5. T'a paska prishë automobilin!
6. Nuk e çaj kokën për automobilin, por për atë; është vrá shumë.
7. Vërtetë? Ku është vrá?
8. Ka vrá keqas nji sý, të djathtin; xhami e ka pré në fytyrë dhe ka thye kambën e majtë.
9. Paska qenë në rrezik me vdekë!
10. Sigurisht! Përditë vdesin njerëz në kët mënyrë.
11. Mbrâmë vdiqën dy vetë tamam para shtëpis sime.
12. E dij. Nji tjetër vdiq trí ditë më parë, në të njëjtat rrethana.
13. Më trego si ngjau aksidenti!
14. Djali thotë se nji automobil, tue dalë nga nji këthesë, i ka pré rrugën.
15. Nuk paska pasë faj djali!
16. Si jo! Duhet t'a kishte ndalë menjisherë.
17. Pse nuk e ka ndalë?
18. Sepse e nget tepër shpejt; e kam këshillue kaq herë me e ngá më ngadalë, sidomos në qytet.
19. Ndoshta ka qenë për ngut.
20. Ai është gjithëmonë për ngut; edhe kur ecën duket sikur nget.
21. Me thánë të vërtetën, edhe ti nget kur ecën.
22. Mirëpo automobilin nuk e ngas shpejt.
23. Në ç'vend u-ndeshën?
24. Nuk e dij tamam ku; në qendër të qytetit, kujtoj.

# LESSON 47



A Car Accident

1. Why are you upset?
2. Why shouldn't I be? One of my sons had a car accident.
3. Which one? The youngest son?
4. No, the oldest. The youngest is very careful.
5. Boy, he must have wrecked your car!
6. I don't care about the car; it's him that I care about, he was badly hurt.
7. Really? Where did he get hurt?
8. He has hurt his eye badly --the right one; the glass cut his face, and he broke his left foot also.
9. He must have been in danger of dying.
10. Sure. In this way people die every day.
11. Two people died last night right in front of my house.
12. I know. Another one died three days ago under the same circumstances.
13. Tell me how the accident happened.
14. The boy says that a car coming out of a curve cut in front of him.
15. It wasn't your boy's fault.
16. Why not? He should have stopped the car at once.
17. Why didn't he stop it?
18. Because he was driving too fast. I have advised him to drive slower, especially in town.
19. Maybe he was in a hurry.
20. He is always in a hurry. Even when he walks he seems to be running.
21. To tell the truth, you run too when you walk.
22. Yes, but I don't drive the car fast.
23. Where did they collide?
24. I don't know where, in the center of town I think.

PJESA E TRETË  
ANALIZË GRAMATIKORE

LESSON 47  
PART III  
GRAMMAR ANALYSIS

NOUNS: Adjectives used as Nouns

An adjective performs the function of a noun whenever it represents a person, animal or action.

I madhi dhe i vogli janë të dy të martuem.  
(The eldest and the youngest are both married.)

As we see in the above statement i madhi and i vogli are two nouns, derived from adjectives, substituting the noun djali - Djali i madh dhe djali i vogël janë të dy të martuem.

Adjectives used as nouns take the form, gender and case of the nouns which they substitute.

Declension of nouns--masculine:

SINGULAR

	Indefinite	Definite
Nom.	nji i mirë	i miri
Gen.	i, e, të nji të miri	i, e, të të mirit
Dat.	nji të miri	të mirit
Acc.	nji të mirë	të mirin
Abl.	prej nji të miri	prej të mirit

PLURAL

	Indefinite	Definite
Nom.	disa të mirë	të mirët
Gen.	i, e, të disa të mirëve	i, e, të të mirëvet
Dat.	disa të mirëve	të mirëvet
Acc.	disa të mirë	të mirët
Abl.	prej disa të mirëve	prej të mirëvet

Declension of nouns ending in -k. Include nouns ending in -g and -h in this group.

## SINGULAR

	Indefinite		Definite	
Nom.		nji frikacak		frikacaku
Gen.	i, e, të	nji frikacaku	i, e, të	frikacakut
Dat.		nji frikacaku		frikacakut
Acc.		nji frikacak		frikacakun
Abl.	prej	nji frikacaku	prej	frikacakut

## PLURAL

	Indefinite		Definite	
Nom.		disa frikacakë		frikacakët
Gen.	i, e, të	disa frikacakëve	i, e, të	frikacakëvet
Dat.		disa frikacakëve		frikacakëvet
Acc.		disa frikacakë		frikacakët
Abl.	prej	disa frikacakëve	prej	frikacakëvet

The use of nouns derived from adjectives:

(a) To substitute a noun previously mentioned, a noun which is superfluous to be mentioned (*i sëmundi*, "the sick man") or to substitute the noun *gjâ*, "thing," (*e vërteta*, "the truth").

(b) More often in definite form.

The following examples will illustrate better the use of nouns derived from adjectives:

Në këtë klasë ka nxënës të këqij e nxënës të mirë; të mirët punojnë, kurse të këqijt s'bajnë gjâ.  
(There are good and bad students in this class; of course the good ones do work, while the bad ones don't do a thing.)

Kërkohen mësues që dijnë gjuhë të hueja. T'interesuemit duhet të paraqesin lutje sa më parë.  
(Teachers who know foreign languages are wanted. Those who are interested should apply as soon as possible.)

Examples: (continued)

Të rijt janë entuziazte.  
(Young people have enthusiasm.)

E vërteta del gjithëmonë në shesh.  
(The truth always comes out.)

Të plagosurit u-çuen në spital.  
(The wounded were taken to the hospital.)

Tryeza ishte mbushë me të gjitha të mirat.  
(All the good things were on the table.)

PJESA E KATËRT  
USHTRIME GRAMATIKORE

LESSON 47  
PART IV  
GRAMMAR DRILL

1. Use the admirative mood when answering your teacher (T.).
- T. Zotni Bardhi ka një shtëpi që kushton 50.000 dollarë.  
S. Ashtu? Zotni Bardhi qenka i pasun!
- T. Unë i nxã përditë të gjitha mësimet  
S. Vërtetë? Ju qenkeni shumë i zellshëm!
- T. Unë jam 52 vjeç.  
S. Vërtetë? Unë qenkam më i ri se ju! Unë jam 51 vjeç.
- T. Ju të dy s'keni bënë asnjë gabim në provim.  
S. Shumë mirë. D.m.th. na qenkemi më të mirët e klasës!
- T. Klasa B ka 3 nxënës që janë më të gjatë se 2 metra.  
S. Vërtetë? Qenkan të gjatë!
- T. Zotni Bardhi ka 11 fëmijë.  
S. Vërtetë? Zotni Bardhi paska shumë fëmijë!
- T. Unë kam blé një automobil të ri. Qe ku është!  
S. Ah, sa ngjyrë të bukur paska! Paskeni blé një automobil të mirë!
- T. A keni një pëndë, ju lutem?  
S. Po, kam.  
(after looking for it):  
Jo, nuk e paskam me vete! E paskam harrue në shtëpi!
- T. Qe provimet! Në çdo fjalë keni bënë nga një gabim.  
S. Ah, sa shumë gabime paskemi bënë!
- T. Nxënësit kanë shkue në shtëpi në orën 5 të mëngjesit dhe kanë ardhë në klasë në orën 8.  
S. Ata s'paskan fjetë veçse 2 orë!



2. Djali i madh është në klasën e katërt.  
 A është i madhi në klasën e katërt?  
 Po, i madhi është në klasën e katërt.  
 Cili djalë është në klasën e katërt?  
 I madhi është në klasën e katërt.

Librat e djalit të madh janë në çantë.  
 A janë librat e të madhit në çantë?  
 Po, librat e të madhit janë në çantë.  
 Librat e cilit djalë janë në çantë?  
 Librat e të madhit janë në çantë.

Mësuesi i tha djalit të madh me studjue më shumë.  
 A i tha mësuesi të madhit me studjue më shumë?  
 Po, mësuesi i tha të madhit me studjue më shumë.  
 Cilit djalë i tha mësuesi me studjue më shumë?  
 Mësuesi i tha të madhit me studjue më shumë.

Ju e patë djalin e madh tue shkue në shkollë.  
 A e pashë unë të madhin tue shkue në shkollë?  
 Po, ju e patë të madhin tue shkue në shkollë.  
 Cilin djalë pashë unë tue shkue në shkollë?  
 Ju e patë të madhin tue shkue në shkollë.

Unë mora prej djalit të madh dy libra.  
 A morët ju prej të madhit ndonji libër?  
 Po, unë mora prej të madhit dy libra.  
 Prej kujt morët ju dy libra?  
 Unë mora prej të madhit dy libra.

Mësuesi i ri është në klasën tjetër.  
 A është i riu në klasën tjetër?  
 Po, i riu është në klasën tjetër.  
 Cili mësues është në klasën tjetër?  
 I riu është në klasën tjetër.

Këta janë rradhorët e mësuesit të ri.  
 A janë këta rradhorët e të riut?  
 Po, këta janë rradhorët e të riut.  
 Rradhorët e cilit mësues janë këta?  
 Këta janë rradhorët e të riut.

Na i a dhamë detyrat e shtëpis mësuesit të ri.  
 A i a dhatë detyrat e shtëpis të riut?  
 Po, na i a dhamë detyrat e shtëpis të riut.

Cilit mësues i a dhatë detyrat e shtëpis?  
 Na i a dhamë detyrat e shtëpis të riut.

Na folëm sot në mëngjes me mësuesin e ri.  
 A folëm na sot në mëngjes me të riun?  
 Po, na folëm sot në mëngjes me të riun.  
 Me cilin mësues folët ju sot në mëngjes?  
 Na folëm sot në mëngjes me të riun.

Na i morëm detyrat e shtëpis prej mësuesit të ri.  
 A i morët detyrat e shtëpis prej të riut?  
 Po, na i morëm detyrat e shtëpis prej të riut.  
 Prej cilit mësues i morët detyrat e shtëpis?  
 Na i morëm detyrat e shtëpis prej të riut.

For supplementary drill:

Ask questions as above with the following phrases:

vllai i vogël punon në fabrikë,  
 rrobagesi i gjatë është 37 vjeç,  
 nxënësi i shkurtë është 20 vjeç,  
 mësuesi plak është në klasë.

3. A ngas unë më shpejt se ai?  
 Po, ti nget më shpejt se ai.  
 Kush nget më shpejt se unë?  
 Unë ngas më shpejt se ti.  
 Çka bën ai më shpejt se unë?  
 Ai nget më shpejt se ti.  
 A ngasin na kur shkojmë me hangër?  
 Po, ju ngitni kur shkoni me hangër.  
 Cilët ngasin kur shkojnë me hangër?  
 Na ngasin kur shkojmë me hangër.  
 Çka bëjnë ata kur shkojnë me hangër?  
 Ata ngasin kur shkojnë me hangër.
- A ngava unë sepse ishem vonë?  
 Po, ti ngave sepse ishe vonë.  
 Kush ngau sepse ishte vonë?  
 Unë ngava sepse ishem vonë.  
 Pse ngau ai?  
 Ai ngau sepse ishte vonë.  
 A ngamë na kur shkuem në kinema?  
 Po, ju ngatë kur shkuet në kinema.

Çka bëtë ju kur shkuet në kinema?  
 Na ngamë kur shkuem në kinema.  
 Cilët nganë kur shkuen në kinema?  
 Ata nganë kur shkuen në kinema.

A do të ngas unë kur të shkoj me blé ilaçet?  
 Po, ti do të ngasish kur të shkojsh me blé  
 ilaçet.

Çka do të bëjsh ti kur të shkojsh në kinema?  
 Unë do të ngas kur të shkoj në kinema.  
 Kush do të ngasi kur të shkojë me marrë fëmijët  
 në shkollë?  
 Ai do të ngasi kur të shkojë me marrë fëmijët  
 në shkollë.

A do të ngasim na kur t'i ulemi kodrës?  
 Po, ju do të ngitni kur t'i uleni kodrës.  
 Cilët do të ngasin kur t'i ulen kodrës?  
 Na do të ngasim kur t'i ulemi kodrës.  
 Çka do të bëjnë ata?  
 Ata do të ngasin kur t'i ulen kodrës.

For supplementary drill:

Ask questions as above with the following phrases:

unë e ngas automobilin mirë,  
 unë e ngas aeroplanin mirë,  
 unë ngas kur due me shkue në shkollë shpejt.

4. A e pres unë mollën me thikë?  
 Po, ti e pret mollën me thikë.  
 Me çka e pret ti mollën?  
 Unë e pres mollën me thikë.  
 Kush e pret portokallin me thikë?  
 Ai e pret portokallin me thikë.  
 A i presim na pemët që janë thá?  
 Po, ju i pritni pemët që janë thá.  
 Cilët i presin lulet që janë thá?  
 Na i presim lulet që janë thá.  
 Çka presin ata?  
 Ata i presin lulet që janë thá.

A e preva unë dorën me brisk?  
 Po, ti e preve dorën me brisk.  
 Çka preve ti me brisk?  
 Unë e preva dorën me brisk.

Me çka e preu ai dorën?

Ai e preu dorën me brisk.

A e premë na pjeshkën sepse ishte thá?

Po, ju e pretë pjeshkën sepse ishte thá.

Cilët e prenë pjeshkën?

Na e premë pjeshkën sepse ishte thá.

Pse e prenë ata mollën?

Ata e prenë mollën sepse ishte thá.

A do t'a pres unë mishin para se t'a há.

Po, ti do t'a presish mishin para se t'a hásh.

Kush do t'a presi mishin para se t'a hajë?

Unë do t'a pres mishin para se t'a há.

Çka do të bëjë ai?

Ai do t'a presi mishin para se t'a hajë.

A do t'i presim na domatet para se t'i bëjmë sallatë?

Po, ju do t'i pritni domatet para se t'i bëni sallatë.

Cilët do t'i presin qepët para se t'i fusin në sallatë?

Na do t'i presim qepët para se t'i fusim në sallatë.

Çka do të bëjnë ata?

Ata do t'i presin qepët para se t'i fusin në sallatë.

5. A e thyej unë shpesh gotën e ujit?

Po, ti e thyen shpesh gotën e ujit.

Kush i thyen shpesh pjatat kur i lán?

Unë i thyej shpesh pjatat kur i láj.

Çka bân ai?

Ai i thyen shpesh pjatat kur i lán.

A i thyejmë na filxhanat nganjherë kur i lajmë?

Po, ju i thyeni nganjherë filxhanat kur i lani.

Cilët i thyejnë nganjherë gotat e ujit kur i lajnë?

Na i thyejmë nganjherë gotat e ujit kur i lajmë.

A i thyejnë ata xhamat e dritorevet nganjherë?

Po, ata i thyejnë nganjherë xhamat e dritorevet.

A e theva unë xhamin e dritores?

Po, ti e theve xhamin e dritores.

Kush e theu filxhanin e kafes?

Unë e theva filxhanin e kafes.

Çka theu ai?

Ai e theu filxhanin e kafes.

A i thyem na pjatat kur po i lajshim?

Po, ju i thytë pjatat kur po i lajshi.

Cilët i thyen pjatat?

Na i thyem pjatat kur po i lajshim.

Çka bënë ata?

Ata i thyen pjatat kur po i lajshin.

A do t'a thyej unë dritoren në qoftë se nuk mund t'a hap?

Po, ti do t'a thyejsh dritoren në qoftë se nuk mund t'a hapish.

Kush do t'a thyejë dritoren në qoftë se nuk mund t'a hapi?

Unë do t'a thyej dritoren në qoftë se s'mund t'a hap.

Çka do të bëjë ai?

Ai do t'a thyejë dritoren në qoftë se nuk mund t'a hapi.

A do t'a thyejmë na derën e automobilit në qoftë se nuk mund t'a hapim?

Jo, ju nuk do t'a thyeni derën e automobilit në qoftë se nuk mund t'a hapni.

Cilët nuk do t'a thyejnë derën e automobilit?

Na s'do t'a thyejmë derën e automobilit.

Çka s'do të thyejnë ata?

Ata s'do t'a thyejnë derën e automobilit.

6. A vdes njeriu nga frika?

Jo, zakonisht, njeriu s'vdes nga frika.

A vdesin shumë njerëz n'Amerikë nga aksidente të ndryshme?

Po, n'Amerikë vdesin mjaft njerëz nga aksidente të ndryshme.

A vdiq dje një nxënës në spital?

Po, dje vdiq një nxënës në spital.

A vdiqën dy ushtarë në një aksident?

Po, dy ushtarë vdiqën në një aksident.

7. A kanë rrugët e Presidios shumë këthesa?  
 Po, rrugët e Presidios kanë shumë këthesa.  
 Cilat rrugë kanë shumë këthesa?  
 Rrugët e Presidios kanë shumë këthesa.  
 Sa këthesa kanë rrugët e Presidios?  
 Rrugët e Presidios kanë shumë këthesa.  
 Çka kanë rrugët e Presidios?  
 Rrugët e Presidios kanë shumë këthesa.
- A u-vrava unë në dorë kur mbylla derën?  
 Po, ju u-vratë në dorë kur mbyllët derën.  
 Kur u-vrã ai në dorë?  
 Ai u-vrã në dorë kur mbylli derën.  
 Kur u-vramë na?  
 Na u-vramë kur mbyllëm derën.  
 Kur u-vranë ata?  
 Ata u-vranë kur mbyllën derën.
8. A kam unë faj që u-prish automobili?  
 Jo, ti s'ke faj që u-prish automobili.  
 Kush s'ka faj që u-prish automobili?  
 Unë s'kam faj që u-prish automobili.  
 Po ai, a ka faj që u-prish automobili?  
 Jo, as ai s'ka faj që u-prish automobili.
9. A është motra e tij shumë e kujdesshme?  
 Po, motra e tij është shumë e kujdesshme.  
 Kush është shumë e kujdesshme?  
 Motra e tij është shumë e kujdesshme.  
 Motra e kujt është shumë e kujdesshme?  
 Motra e tij është shumë e kujdesshme.  
 Qysh është motra e tij?  
 Motra e tij është shumë e kujdesshme..
- A e ngitni automobilin n'anën e majtë të rrugës?  
 Jo, unë nuk e ngas automobilin n'anën e majtë të rrugës.  
 Kush nuk e nget automobilin n'anën e majtë të rrugës?  
 Unë nuk e ngas automobilin n'anën e majtë të rrugës.  
 Çka nuk ngitni n'anën e majtë të rrugës?  
 Unë nuk e ngas automobilin n'anën e majtë të rrugës.  
 Ku nuk e ngitni automobilin?  
 Unë nuk e ngas automobilin n'anën e majtë të rrugës.  
 Në ç'anë të rrugës e ngitni ju automobilin?  
 Unë e ngas automobilin n'anën e djathtë të rrugës.

1. Kur ishem fëmijë shkojshem shpesh në shtëpinë e një shoku për të luejtë, sepse jona ishte e vogël. Shtëpija e tij ishte e madhe e kishte edhe një kopsht mjaft të madh. Në një pjesë të këtij kopshti prindët e shokut mbillshin zarzavate, si domate, sallatë, qepë etj. Pjesa tjetër e kopshtit kishte pemë, si qershi, dardha, pjeshka etj.

S'e harroj kurrë kohën që kam kaluar në shtëpinë dhe në kopshtin e shokut tim. Ka qenë një ndër kohët më të bukura të jetës sime.

2. Dje në drekë tue shkue në shtëpi pashë në rrugë një fëmijë të vogël, një 5 vjeç, që po qante. Duket se kishte humbë rrugën. M'erdhi keq që s'munda me u-ndalë; s'kishem kohë.

3. Mbrëmë i lapa vetë këmbisat, çorapët dhe shapët. Arsyeja është se s'kam të holla me i çue me i lapa në qytet. Megjithatë s'kam lapa rrobe ndonjiherë, kur i pashë sot në mëngjes m'u-duken mjaft të pastra.

4. Dje jam lapa me ujë të ftoftë sepse s'kishem ujë të nxehët. Po t'ishte verë ndoshta do të më pëlqente, por në dimër s'më pëlqen aspak me u-lapa me ujë të ftoftë.

5. Ka ca kohë që djali im s'e ndien vetën mirë. Ka kollë shumë. Dje shkoi ke mjeku, i cili i tha se s'kishte ndonji sëmundje me rëndësi, por e këshilloi mos të pijë duhan shumë.

6. Në Shqipëri zakonisht nuk bëjnë kostume gati sepse shumica e njerëzvet i bëjnë rrobet ke rrobaqepsi. Atje ka shumë rrobaqepës dhe janë të mirë, kështu që s'kanë nevojë të bëjnë e të shesin rrobe gati.

7. Nji javë më parë shkova ke dentisti për arsye se më dhimbte nji dhamb. Dentisti e shikoi dhe më tha se dhambi ishte prishë e më këshilloi t'a hiqshem. Unë i thash "mirë" dhe ai m'a nxori, por më dhimti mjaft dhe më qiti gjak shumë. At natë s'munda me fjetë prej dhimbe, prandej të nesërmen s'dola në punë fare.

---

My hometown is not a big town. It's quite pretty and has a good climate. The spring is beautiful, when it doesn't rain too much. In summer it gets quite warm and the fall is wonderful. In winter it gets very cold and it is humid too. It



never gets foggy. We don't know what fog is.

The town is on a plain (field) and it's built on the shore of a lake. It has beautiful houses, buildings and wide streets.

The town has several schools. It has quite a few factories, among them a shoe factory, cigarette factory, soap factory, etc. There are two theaters, a library and a hospital.

In my hometown very few people have cars; therefore, the rate (number) of car accidents is very small. I remember only one person that died in a car accident, and at that time they said he had drunk too much just before the accident happened.

This in short (in a few words) is the story of my hometown. Perhaps it's not an important town, but to its inhabitants it's quite important.

Zotni Sadik Kodra ka dy djelm; i madhi është 18 vjeç dhe i vogli 16 vjeç. Dje në drekë, djali i madh, ndërsa po shkonte në qytet, pati një aksident me automobil. Nga një këthesë e rrugës doli një automobil dhe i preu rrugën. Vedati (djali i madh i Zotni Sadik Kodrës) nuk e ndaloi automobilin me kohë, kështu që u-ndesh me të. Automobili është prishë shumë dhe Vedati është vrá mjaft: ka thyë kambën e majtë në dy vende, ka vrá synin e djathtë dhe xhami i thyem e ka pré në fytyrë. Vedati do të kishte mundë edhe me vdekë. Përditë vdesin njerëz n'aksidente automobili.

Dy ditë më parë dy njerëz vdiqën në të njëjtat rrethana jo shumë larg nga shtëpia e Zotni Sadik Kodrës e tri ditë më parë një tjetër vdiq po aty afër.

Vedati është shofer mjaft i mirë, por ka një zakon të keq: e nget automobilin tepër shpejt. Zotni Sadiku e ka këshillue kaq herë me e ngá më ngadalë, por Vedati është ende i ri e harron shpejt. Edhe Ganiu, djali i vogël i Zotni Kodrës, di t'a ngasi automobilin, por ai është më i kujdesshëm se Vedati.

Vedati do të qëndrojë në spital një katër a pesë ditë e mandej do të këthenet në shtëpi.

## QUESTIONS - PYETJE

1. Sa djelm ka Zotni Sadik Kodra?
2. Sa vjeç është i madhi dhe sa vjeç i vogli?
3. Cili prej djelmvet pat dje në drekë një aksident me automobil?
4. Kush pat një aksident dje në drekë ndërsa po shkonte në qytet?
5. Çka i ngjau djalit të madh dje në drekë?
6. Prej nga doli një automobil dhe i preu djalit rrugën?
7. Çka bëri një automobil nga një këthesë e rrugës?
8. Kush nuk e ndaloi automobilin me kohë?
9. Me çka u-ndesh, kështu, Vedati?
10. Cili automobil është prishë shumë?
11. Kush është vrá mjaft?
12. Kush ka thyer kambën e majtë në dy vende?
13. Cilin shtëpi ka vrá Vedati?
14. Kë ka prë në fytyrë xhami i thyer i automobilit?
15. Kush do të kishte mundë edhe me vdekë?
16. Kur vdesin njerëz në aksidente automobili?
17. Kur vdiqën dy njerëz jo shumë larg nga shtëpia e Zotni Sadik Kodrës?
18. Kush është shofer mjaft i mirë?
19. Çfarë zakoni të keq ka Vedati?
20. Kush e ka këshilluar Vedatin kaç herë me e ngatërruar automobilin më ngadalë?

21. Kush është ende i ri e harron shpejt?
22. Edhe kush tjetër di t'a ngasi automobilin, por është më i kujdesshëm se Vedati?
23. Çka bën Ganiu?
24. Ku do të qëndrojë Vedati nja katër a pesë ditë?
25. Kush do të këthehet mandej në shtëpi?



- Ata që banojnë në katin e pestë të banesës sonë janë të bezdisshëm. Mbramë në mesnatë i ranë me shqelma dyshe-mesë sa mundshin.  
 - A ju zgjuen?  
 - Për fat jo; unë po i bijshem pianos gjatë asaj kohe.

PJESA E SHTATË  
DETYRË SHTËPIJE

LESSON 47  
PART VII  
HOMEWORK

A. Answer the following questions using adjectives used as nouns. Example:

Q. Cili prej djelmvet tuej quhet Agim: djali i madh apo djali i vogël?

A. I vogli quhet Agim.

1. Cili automobil ju pëlqen më shumë: automobili i kuq apo automobili i verdhë?
2. Me cilin automobil do të shkoni: me automobilin e ri apo me automobilin e vjetër?
3. Cilin krah ka vrá: krahun e majtë apo krahun e djathtë?
4. Cilët fëmijë janë nxânës më të mirë: djelmt e mëdhaj apo vajzat e vogla?

B. Translate into Albanian:

5. My father died 20 years ago.
6. I cut my left hand with a knife.
7. Who broke the windowpane?
8. He left one hour ago; he was in a hurry.

C. Translate into English:

9. Ç'automobil të bukur paska ky zotni!
10. Ashtu? Vetëm 4 orë në natë flëni? Ju fjetkeni shumë pak!

PJESA E TETË  
FJALORI

LESSON 47  
PART VIII  
VOCABULARY

aksident, -i aksidente, -t	(m.)	accident
i, e, të djathtë të djathta	(adj. m. & f.)	right (opposed to left)
i djathti, e djathta	(m. & f.)	the right one (op- posed to the left one)
keqas	(adv.)	badly
këthesë, -a këthesa, -t	(f.)	curve, turn
i, të kujdesshëm e, të kujdesshme	(adj. m. & f.)	careful
i, e, të majtë të majta	(adj. m. & f.)	left (opposed to right)
i majti, e majta	(m. & f.)	the left one (op- posed to the right one)
i, e, të mërzitun të mërzituna	(adj. m. & f.)	upset, bored, annoyed
mirëpo	(conj.)	however
me u-ndeshë (unë ndeshem)	(v.)	to collide, meet, encounter, clash, bump
me ngá (unë ngas)	(v.)	to run; drive; tease
ngadalë	(adv.)	slowly, gently, gradually; easy (not in a hurry)
me ngjá (ngjan)	(v.)	to happen, occur; to resemble
me pré (unë pres)	(v.)	to cut


me prishë (unë prish)	(v.)	to break, ruin, de- stroy; spoil; erase; squander; change (money); harm, upset (stomach); decay (teeth)
rrethanë, -a rrethana, -t	(f.)	circumstance
rrezik, -u rreziqe, -t	(m.)	danger, risk, peril
sikur	(conj.)	as, as if, as though
me thye (unë thyej)	(v.)	to break; change (money)
me vdekë (unë vdes)	(v.)	to die (for people)
me vrá (unë vras)	(v.)	to hurt, injure; to kill (by shooting)
me u-vrá (unë vritem)	(v.)	to be (as above)
xham, -i xhama, -a	(m.)	glass, windowpane

---

NOTES:

Nuk e çáj kokën.	I don't care.
kaq herë	so many times
Si mos me qenë!	Why shouldn't I be!
me qenë për ngut (unë jam për ngut)	to be in a hurry
me qenë në rrezik (unë jam në rrezik)	to be in danger
Si jo!	Why not? (of course)
me thënë të vërtetën	to tell the truth

## Fjalë Kryq



1. Gjuha që po nxëni.
2. Nji nga gradat e nënoficeravet.
3. Keni 6 orë në ditë.
4. Ata që pini kur ju dhemb kryet.
5. Ujë që del nga toka.
6. Kur bje fillon ase mbaron mësimi.
7. Kur marrim, zakonisht na gëzojnë.

\*\*\*\*\*

Në qoftë se e keni bërë mirë, shkronjat e çdo rrethi, tue fillue nga nalt, do të formojnë nji fjalë që tregon nji gjë që, kur quhet e bardhë n'Amerikë ka vetëm nji.

Përgjegjet janë në faqen e fundit të këtij vëllimi.



